



Fretërit Karmelitanë
Kuvendi i Shën Jozefit
NËNSHAT – SHKODËR
SHQIPËRI (ALBANIA)
www.carmelitaniaalbania.org

A KENI PARË ËNDËRRA?

Të dashur vëllezër e motra, miq e mike të misjonit karmelitan, ja po ju shkruajmë përsëri në këtë nëntor të dytë të pranisë tonë në Shqipëri. Ka kalur pak më shumë se një vit që kur kemi mbërritur në këtë vend me kaq shumë kontradikta, nganjëherë shumë i ngjashëm me Galilenë e kohës së Ungjijve por gjithsesi shumë më i larmishëm dhe kompleks në krahasim me përshtypjen që na ishte krijuar në fillimin e misjonit tonë.

Javët e fundit komuniteti ynë ka qenë pak si shumë shpërndarë. Njëri pas tjetrit kemi shkuar për "pushime" në Itali, menjëherë mbas vizitës së Papës, për të takuar dhe përqaftuar familjet tona, vëllezërit e motrat Karmelitanë, miqtë tanë në mes të të cilëve edhe ndonjerin prej jush. Ky ka qenë kthimi ynë i parë në Itali që kur jemi vendosur në Shqipëri: tre javë intensive gjatë të cilave fëtyrat tuaja të dashura na dilnin para syve; por edhe tre javë gjatë të cilave kemi ndjerë mall për ata fëtyra që tashmë janë shoqëruese të misjonit tonë. Kështu e kemi kuptuar se mbas një viti në "planetin Shqipëri" ... jemi tashmë pezull mes dy botësh: nuk jemi më plotësisht italianë por as nuk jemi akoma krejtësisht shqiptarë. Për më tepër, sapo jemi kthyer këtu shumë kush na ka pyetur pak si me ndrojtje: "A ju ka munguar Shqipëria?". Edhe këtu tashmë shumë vetë na presin dhe na ndjejnë si të "shtëpisë". Përgjigja më e sinçertë që mund t'u japim atyre, në fund të fundit është thjesht: "po". Po, na ka marrë malli!

Me rradhë kemi vazhduar edhe transferimet për të studjuar pranë motrave françeskane në Lezhë. Studimi na ka ndihmuar në zgjidhjen e gjuhës dhe na e ka larguar ndruajtjen aq sa kemi arritur të komunikojmë dhe të predikojmë pa letër, ndoshta pak "*partizanshe*", siç ka komentuar ndonjë, por, nëse e krahasojmë me atë që arrinim të bënim një vit më parë, kur mendojmë vështirësitë që kemi hequr, frikën dhe dekurajimin që kemi kapërcyer, është një alamet kënaqësie!

Ndërsa njëri nga ne ishte në Itali, tjetri në Lezhë për të studjuar gjuhën, matematica na mëson se i treti ka ngelur vetëm në Nënshat. Ishte pak jo normale që mbas një viti të gjendeshe prap i vetëm në manaxhimin e "misjonit". Kemi patur shansin të praktikojmë një lloj "jete prej eremitit", të vetëm në kuvendin spital, madje edhe pa drita në pjesën më të madhe të ditës (e të natës...) dhe me murlanin e ftohtë që ulërinte në dritare për një javë rresht.

Kemi zbuluar se nuk është edhe aq e thjeshtë jeta e "eremitëve": ndërsa mendonim se do të kalonim disa javë në vetmi duke studjuar e duke u lutur, jemi detyruar t'i bënim ballë të vetëm të gjitha impenjimeve të ndryshme: meshë, rrëfime, vizita që duhej të bënim e që na vinin, detyra në qytet, kontrolle në kantier dhe të papritura të ndryshme! Mund të themi se momentet gjatë të cilave e kemi "shijuar" pak vetminë kanë qenë vertetë të pakta: lëre pastaj "jetën prej eremitësh"! Së fundmi Adolfi ka shkuar në Gjirin e Kotorit, në Mal të Zi, për të predikuar për dy javë ushtrimet shpirtërore të françeskanëve shqiptarë.

Me rastin e festës solemne të Shejtes Terezë të Jezusit, me 15 tetor, e gjithë familja është bashkuar për fillimin zyrtar të celebrimeve me rastin e pesëqind vjetorit të lindjes së saj. Gjatë

celebrimit solemn, sipër në kishën e Karmelit, ipeshkëv Lucjani ka theksuar se është hera e parë që pranë murgeshave ndodhen edhe vëllezërit. Kur do të jenë edhe shekullarët? Kisha ishte plot. Bashkëcelebruesit ishin rreth pesëmbëdhjetë vetë, më shumë se sa prioni. Kjo na tregoi se sa shumë miq e dashamir ka Karmeli Shqiptar. Për këtë rast kishim shtypur një libërth mbi jetën e Nënës Shejte dhe të gjithë pjesëmarrësve i kemi dhuruar nga një kopje. Gjatë gjithë këtij viti, dedikuar Sh. Terezës së Jezusit, do të vazhdojmë të shpërndajmë kopje të librit në aktivitetet e tjera të këtij pesëqindvjetori "shqiptar".

Mbasditen e 14 tetorit kemi dashur të celebroidjmë natën e festës në Kotërr, një fshat këtu afër, ku falë një bamirsi spanjoll, ndodhet e vetmja kishë shqiptare e dedikuar Shejtes Terezë. Gjatë omelisë, atë Marjani është munduar t'u trasmetojë besimtarëve të pranishëm një nga mësimet themelore të Terezës, sipas të cilit lutja autentike më shumë se në thënjen e uratëve konsiston në një bashkëbisedim me Hyun ... Ta kenë kuptuar vallë? T'i kenë dhënë rëndësi këtyre fjalëve? Ashtu siç thotë edhe Jezusi: ne fillojmë të mbjellim, të tjerë do të korrin.

Sipas kalendarit të pushimeve që kishim caktuar më përpara, dita e një vjetorit të ardhjes sonë në Shqipëri, data 30 tetor, fatkeqësisht na gjeti të ndarë. Adolfi dhe Paolo Maria ndodheshin në Nënshat e festonin "në familje", te motrat, me një *bakllavà* shumë të ëmbël të bërë në shtëpi. Kjo ishte hera e parë që hanin bakllavà që prej njëmbëdhjetë vjetësh. Ndërsa Marjani ndodhej në Sicili dhe e ka festuar këtë përvjetor me një vizitë në të famshmen Piana degli Albanesi, pranë Palermos, ku banojnë pasardhësit e shqiptarëve që pesë shekuj më parë, u detyruan të largoheshin nga atdheu i pushtuar nga Turqit. Ai e festoi përvjetorin me kanolet tipike të asaj zone dhe me kërkesën e bërë nga disa arbëreshë që ka takuar atje: "përkulu për ne!", domethënë "lutu" sipas traditës orjentale.

Çfarë mund të themi duke dashur të bëjmë një bilanc mbas vitit të parë në tokën e shqiptonjave?

Na kishin thirrur befasisht të vinim në Shqipëri dhe jemi nisur ndërkohë që Kisha celebrante vitin e besimit, me sytë drejt atë Abramit i cili "*për besim. i thirrur nga Zoti, u nis për në vendin që do të trashëgonte, dhe u nis pa e ditur se ku po shkonte...*" (Heb 11,8). Na dukej sikur rijetonim drithërimat e tij, ankthin e tij e frikën e tij.

Me kalimin e vitit jemi ndjerë, më saktë jemi gjendur, të shoqëruar nga "motrat" që na kanë marrë për dore e na kanë drejtuar qysh prej mbërritjes tonë këtu. Maria e para e të gjithave, si nëna, si mbretëresha e si motra e karmelitanëve qysh prej fillimeve të tyre në Tokën e Shejtë, siç ju kemi treguar herë të tjera. Pastaj Tereza, nëna e shejtë, që na ka sjellë këtu pikërisht në pesëqind vjetorin e lindjes së saj, ajo që i kishte aq shumë për zemër komunitetet e reja të fretërve të zbatuar dhe misjonet. Së fundmi bijat e saj këtu në Nënshat, që na kanë mirëpritur me dashuri të veçantë, mbasi kishin pritur për një kohë të gjatë dhe ishin lutur për ardhjen e vëllezërve këtu.

Mbas një viti që kemi ecur së bashku mirnjohja jonë ndaj tyre është e madhe, dhe nëse ndonjë herë nuk jemi kuptuar, për faj të gjuhës e të mentalitetit të ndryshëm, kjo ka ndodhur sepse akoma jemi në fazën e njohjes, dhe sa më shumë njihemi aq më shumë vërtetë e duam njëri-tjetrin! Kemi gjithmonë besim tek premtimi që Zotynë i ka bërë Pjetrit: kush ka lënë shtëpi e vëllezër e motra e nëna e bij për të, do të gjejë qysh në këtë jetë njëqind herë më shumë ... (përkufizim nga Mk 10,29).

Edhe një figurë tjetër, diskrete dhe e heshtur, na ka shoqëruar gjithnjë gjatë këtyre muajve. Një figurë burri ndër gjithë këto gra! Një atë e një vëlla: njeriu i ëndërrave ...

Në Shqipëri ndodh të të pyesin në mëngjes: "A keni parë ëndrra?" Këtu ëndërrat nuk "bëhen" por "shihen". Në Perëndim ose i interpretojmë ëndërrat duke u përpjekur të kuptojmë ndërgjegjen tonë ose (dhe kjo ndodh më shpesh) "ëndërr" quajmë dëshirat e projektet tona pak a shumë të realizueshme. Në Shqipëri jo, këtu mbijeton një traditë më e hershme dhe ndoshta më e mençur. Këtu ëndërrat na dhurohen dhe ne mund t'i shohim e, nëse arrijmë ta kapim, përmbajnë një mesazh që vjen nga lart, jo nga vetvetja jonë.

Kështu i ndodhi edhe Jozefit, jo patriarkut ëndërrimtar që zihej me vëllezërit, por pasardhësit të tij me të njëjtin emër, "bashkëshortit të Marijes, nga e cila ka lindur Jezusi i quajtur Krisht" (Mt 1,16). E kishim zgjedhur si mbrojtës tonin, ndoshta pa e kuptuar mirë rrjedhjen e kësaj zgjedhjeje, thjesht duke ndjekur ftesën e Sh. Terezës që e rekomandon si mbrojtës e si mësues në lutje si për shkak të familjaritetit të gjatë të tij me Jezusin në Nazaret, ashtu edhe sepse Sh. Jozefi është njeriu që i mirëpret ëndërrat e Zotit. Ashtu si gjithë të tjerët edhe ai me siguri kishte planet e veta për të ardhmen. Zoti ia shprishi ato dhe i propozoi që të pranonte planin e menduar nga Dikush tjetër e të filluar nga një grua.

Nuk është kollaj për ne burrat që jemi kaq xhelozë ndaj pamvarësisë sonë dhe planeve tona, nuk ka qenë e lehtë as për të, na lë të kuptojmë Shkrimi i Shenjtë. Megjithatë Sh. Jozefi e mirëpret ëndërrën që sheh dhe e pranon si të vetin birin e Zotit duke e bërë atë bir të Davidit. Kështu fillojnë të realizohen premtimet e Zotit dhe në fund është Zoti ai që i bën të vetët bijtë e njerëzimit.

Ne nga pak e nga pak kemi zbuluar se nuk mund të kishim një mbrojtës më të mirë se Sh. Jozefin. Jo vetëm sepse, sipas Sh. Terezës, ai ka aftësinë të ndërmjetësojë për çdo nevojë tonën; jo vetëm sepse na mëson familjaritetin e heshtur dhe intim me Jezusin; por sepse mbi të gjitha edhe ne na kërkohet të "pranonim ëndërrën e Dikujt tjetër". Ishte ëndrra e Zotit ajo që na thërriste në këtë tokë dhe në fund të fundit ishte edhe ëndrra e motrave tona prej shumë vitesh.

Shumë herë jemi lutur, në fund të lutjeve të mesditës duke kujtuar këto fjalë: "*Mos ki frikë o Jozef ta marrësh Marijen*", shumë herë të tjera kemi shtuar gjatë lutjes së Mbrëmëorit kërkesën tonë të sinqertë: "O Zot na ndihmo ta kuptojmë gjithnjë e më mirë misjonin tonë, detyrën që na ke besuar në këtë vend, në mes të këtij populli, në këtë kishë!"

Në fillim na dukej se duhej të bënim pikërisht si Sh. Jozefi: të merrnim përsipër një histori, një misjon që të tjerë njerëz e kanë ëndërruar dhe e kanë nisur. Ta pranonim pa frikë sepse ajo që po ndodhte vinte nga Shpirti i Shejtë dhe ishte dhuratë e Zotit. Ashtu si Sh. Jozefit edhe ne na kërkohet që të përkujdeseshim për Karmelin Shqiptar të përbërë veç nga gratë; ashtu si Sh. Jozefi edhe ne kemi luftuar me tundimin që ta linim Marijen me historinë e saj, me fëmijën e saj, me ëndërrat e veta. Ka qenë një babë vërtetë fantastik me ne Sh. Jozefi: i kemi kuptuar shumë më mirë vështirësitë e tij dhe mendojmë se veç ai ka arritur t'i kuptojë vështirësitë tona!

Prej kaq kohe tashmë jemi "duke e parë këtë ëndërr" që po realizohet. Ajo po konkretizohet me ekperiencat që jetojmë. Edhe pse të brishta e të tjeshta, ato na tregojnë rrugën për të ardhmen e misjonit tonë. Mbas një viti mund të themi se:

- Do të jemi një komunitet i vogël i karmelitanëve terezjanë për të cilët mund të thuhet: "Duket se e duan fort njëri - tjetrin!" - ashtu siç na ka rastisur edhe ne të komentojmë një vit më parë për komunitetin françeskan të Palestrinës në Romë e të paharruarin Padër Gjakomo Bini.
- Do të jemi një shtëpi mikpritëse, sipas traditës së mirfilltë shqiptare, një vend ku kush arrin do ta gjejë derën e hapur ku do të mund të pushojë nga problemet e preokupimet e veta, ku do ketë njerëz që i dëgjojnë hallet, dhe ndajnë me të jetën e tyre, lutjet dhe bukën. Ashtu si

në shtëpinë e Nazaretit ku për një kohë të gjatë jetoi e punoi Sh. Jozefi, e ashtu si në Betania ku ishte shtëpia e miqve të Jezusit, të cilën Sh. Tereza e propozon si model për Karmelin e reformuar. *"Dashuria vëllazërore të mbetet e fortë. Mos harroni mikpritjen; disa duke e praktikuar, pa dashje kanë futur në shtëpi engjëj"* (Eb 13, 1-2).

- Tani për tani nuk do të jemi në rradhët e para ashtu si misjonarët që kanë ardhur para nesh në këtë vend, por do t'i shërbejmë kishës shqiptare duke ndihmuar priftërinjtë, rregulltarët e rregulltarët në detyrat e tyre apostolike.
- Do të jemi në shërbim të të gjithë popullit shqiptar, i cili nganjëherë na kujton popullin Israelit në kohën e Jezusit, si ndërmjet katolikëve me traditë të lashtë në Veri ashtu edhe në Jug ku shumë vetë nuk e kanë dëgjuar asnjëherë Ungjillin...
- Mbi të gjitha do të jemi në shërbim të këtij populli me moshë të re, siç na e ka kujtuar Papa më 21 shtatorin e kaluar; do të jemi në shërbim të të rinjve që ato *"të jenë të fortë dhe fjala e Zotit të mbetet ndër ta e t'a mundin Djallin"* (përkufizim nga 1Gjn 2,14), duke marrë shembull nga shumë të rinj martirë që derdhën gjakun e tyre disa vite më parë në këtë vend.
- Do të përpiqemi të *"ngushëllojmë ato që ndodhen në çdo lloj mundimi me ngushëllimin që ne vetë marrim nga Zoti"* (1 Kor 1,4), ashtu siç na kujtoi papa Françesku në Katedralen e Tiranës, duke na bërë thirrje që të mos kërkojmë ngushëllime në gjëra të tjera që nuk funksionojnë dhe të jemi të vëmendshëm ndaj dhimbjeve të shumta të këtyre njerëzve.

Kjo është çka na duket se shohim në të ardhmen e misjonit tonë në Shqipëri. Një vit më parë kjo nuk ishte ëndrra jonë; prej sa kohësh tashmë e shohim çdo mëngjes gjithnjë e më të qartë, gjithnjë e më reale. Po ju, a keni parë ëndrra?

21 Nëntor 2014

Atë Mariani, Atë Adolfi, Atë Paolo Maria